



Aleksandër Xhuvani është diplomuar për herë të parë në në Fakultetin e Inxhinierisë, Universitetit të Tiranës (Shqipëri) për Inxhinieri Elektrike Industriale. Më pas ai diplomohet përsëri në Francë, në degën Inxhinier në Elektronikë Industriale dhe DEA (Diplôme d'Etudes Approfondies) në fushën e Gjenit Elektrik në ENSEEIHT (Ecole Nationale Supérieure d'Electrotechnique, d'Electronique, d'Informatique et d'Hydraulique de Toulouse).

Më vonë ai fitoi gradën shkencore "Doktor" pranë Institutit Kombëtar Politeknik të Tuluzës dhe së fundmi ka përfunduar studimet Master në Administrim Biznesi në Universitetin Montesquieu-Bordeaux IV, në Francë.

Z. Xhuvani e filloi karrierën e tij shkencore në Shtator 1985 si studiues në LEEI (Laboratoire d'Electrotechnique et d'Electronique Industrielle) të ENSEEIHT. Nga nëntori 1989 deri në janar 1992 ai ka mbajtur detyrën e pedagogut në Fakultetin e Inxhinierisë në Universitetin e Tiranës. Nga janari 1992 deri në janar 2008 ai ka mbajtur detyrën e Drejtorit për Marrëdhëniet Ndërkombëtare Universitetin Politeknik të Tiranës (UPT) dhe gjithashtu ka ushtruar edhe detyrën e Profesorit të brendshëm me kohë të plotë në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike.

Që nga Janari 2008, Z. Aleksandër Xhuvani mban pozicionin e Profesorit në departamentin e Shkencave Kompjuterike, në fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, pranë UPT-së. Ai është anëtar i Këshilli Shtetëror Shqiptarë për Arsimin e Lartë dhe Shkencën, anëtar i Akademisë Shqiptare të Arteve dhe Shkencave dhe që nga viti 1998 mban pozicionin e Drejtorit të "Institut Français de Gestion" në Tiranë pranë UPT-së.